



Ambasciata d'Italia
Tirana

Ambasada italiane në Tiranë

prezanton ekspozitën

I VEGGENTI

Patrick Tuttofuoco dhe Andrea Anastasio

Kuruar nga Davide Quadrio dhe Ajola Xoxa

Në bashkëpunim me Harabel Contemporary Art Platform, Arthub dhe Capo d'Arte

21 korrik - 15 Shtator 2021

Tiranë, Shqipëri

Vila e vjetër në zonën e Bllokut |Rr. Ibrahim Rugova, përballë One Telecommunications

Ambasada italiane në Tiranë, në bashkëpunim me Harabel Contemporary Art Platform, duke nisur nga data 21 korrik, deri më 15 shtator, do të prezantojë ekspozitën “I VEGGENTI” në Tiranë, nga artistët **Patrick Tuttofuoco** dhe **Andrea Anastasio**, kuruar nga **Davide Quadrio** dhe **Ajola Xoxa**, krijuar nga **Arthub** me koordinimin e **Francesca Bonomo** nga shoqata **Capo d'Arte**.

Kjo ekspozitë përbën episodin e parë të një rrugëtimi që do arrijë kulmin e tij në 2022, kur dy artistët italianë Patrick Tuttofuoco dhe Andrea Anastasio, protagonistë të projektit, të kthejnë në të përhershëm në një hapësirë publike në Tiranë, frytin e kërkimit të tyre të një natyre komplekse, të kryer mes arkitekturës, hapësirës relacionale dhe historisë, e cila i shikon për herë të parë duke shfaqur së bashku një seri punimesh, shumë prej të cilave janë krijuar ad hoc.

Duke ardhur prej brezash dhe praktikash artistike të ndryshme, Tuttofuoco dhe Anastasio kanë pranuar ftesën për të punuar më vete, por njëkohësisht së bashku, në një projekt specifik në Tiranë, në të cilin reflektimi mbi kulturën dhe historinë e ndërlikuar të Shqipërisë do të mund të takohet me ndjeshmërinë e tyre artistike.

Patrick Tuttofuoco punon prej dhjetëra vitesh në sferën publike, duke krijuar punë që lidhin vendet historike të zonës me pop kulturën bashkëkohore: instalacione monumentale, duke përfshirë arkitekturën, krijime enigmatike dhe totemike që i dhurojnë publikut emocione shumëngjyrëshe dhe të mprehta.

Andrea Anastasio është një autor i cili punon me medime të ndryshme në fushën e dizajn-it, arkitekturës dhe artit pamor. Të gjitha punët e tij karakterizohen prej nënkuptimesh filozofike dhe shpesh kanë një natyrë performuese: Anastasio ndërhyt me materialin dhe me arketipet e fshehura, duke krijuar përherë truke vizuale të reja që sjellin efekte emocionale komplekse.

Ekspozita “I VEGGENTI” është pritur shumë nga ambasadori i Italisë në Shqipëri, Z. Fabrizio Bucci, dhe shënjon një kapitull të ri në marrëdhënien kulturore mes Italisë dhe Shqipërisë.



Ambasciata d'Italia
Tirana

"Ky projekt vendos një bashkëpunim të ri në artin bashkëkohor midis dy vendeve tona. Një rrugëtim zbulimi, krijimtari dhe bashkëndarjeje, sjellë në Shqipëri nga dy artistë të mëdhenj italianë. Punimet e tyre, të rrëfyera nga përvoja njëzetvjeçare e Davide Quadrio dhe të realizuara falë bashkëpunimit të frytshëm me Harabel, jam i sigurt se do të ndihmojnë për të forcuar vlerën e artit publik në Tiranë dhe për të paraqitur në një mënyrë të re lidhjen midis historisë, mitologjisë dhe bashkëkohësisë shqiptare", shpjegon ambasadori Bucci.

"Harabel e konsideron "I VEGGENTI" jo vetëm si një mundësi për të prezantuar para publikut shqiptar mendimin artistik provokues dhe ironik, të sjellë nga artistët Patrick Tuttofuoco dhe Andrea Anastasio përmes një ekspozite të ngritur në një vilë të vjetër, që shërbeu si shtëpi e nomenklaturës komuniste para vitit 1991, por edhe një ndërhyrje të freskët dhe tunduese në qytet, që do të lërë pas jehonën e saj përmes dy instalimeve të artit publik, të cilat do të ekspozohen përgjithmonë", thotë Ajola Xoxa, një nga themeluesit e Harabel dhe bashkëkuratore e ekspozitës.

"Capo d'Arte, një shoqatë kulturore jofitimprurëse në Salento e angazhuar në përhapjen e artit bashkëkohor, është krenare që promovon një projekt për të rritur ndërgjegjësimin mbi përsosmërinë e artit bashkëkohor italian jashtë vendit, duke na lejuar kështu të shohim peizazhe artistike të panjohura dhe të eksplorojmë botë të ndryshme krijuese në dy vende aq afër sa Shqipëria dhe Italia", thotë Francesca Bonomo, themeluese e Capo d'Arte.

"Ardhja nga Italia dhe takimi me një kulturë kaq të pasur dhe shumështrësëshe, që ka aq shumë për t'i dhënë anës tjetër të detit Adriatik, ishte një udhëtim me të vërtetë i papritur dhe një zbulim që hap një rrugë afatgjatë të kërkimit dhe bashkëpunimit", tha Davide Quadrio, bashkëkurator i ekspozitës dhe themelues i Arthub.

EKSPOZITA

Në vilën e vjetër në rrugën Ibrahim Rugova, ku do të mbahet ekspozita, vizitori do ta gjejë veten në një itinerar që së pari do ta çojë atë të drejt takimit me tri vepra të Tuttofuoco-s dhe dy të Anastasio-s në katin e parë.

Calypso, Laelia, Cambria, punuar nga Tuttofuoco, janë tri maska qeramike në formë petali, të cilat vëzhgojnë vizitorin nga maja e një mbështetëse prej metali të ashpër, të vendosura si një skuadër ushtarake e ngarkuar për t'i dhënë ekspozitës mbrojtjen e një elementi mashkullor. Të tria maskat u prodhuan falë Ceramiche Gatti, sponsori teknik i ekspozitës.

Time Capsule, gjithashtu nga Tuttofuoco, është një pasqyrë e vendosur në mur, në të cilën është shtypur një imazh krahësh dhe duarsh të ndërthurura, një gjest i rezistencës dhe i bashkësisë.

The Path përfaqëson një nga fushat e reja kërkimore të Patrick Tuttofuoco, jo vetëm për mediumin (neoni) që ka qenë gjithmonë pjesë e gjuhës së tij krijuese, duke e "historicizuar" atë në një traditë moderne-bashkëkohore që kishte paraardhës të shquar si Fontana, por veçanërisht për hulumtimin mbi një aspekt "humanizues" dhe referencat jo aq abstrakte, gjeometrike ose agresive ndaj artit të rrugës. "The Path" është një gjest ndriçues, një mirësearchje poetike për t'u rilidhur me njerëzimin: dy duar në një bisedë të vendosur me një gjest shoqëror.



Ambasciata d'Italia
Tirana

The Hours, nga Anastasio, është një llambadar i madh venecian, i punuar me dorë në xham Murano të fryrë, i cili përçon dritën nga tavani në dysheme, duke përforcuar ndarjen midis funksionit dhe formës dhe duke ndryshuar perceptimin hapësinor të të brendshmes.

Room with a view, gjithashtu nga Anastasio, është një batanije dyfishe, e cila del nga një dysheme me pllaka të bardha, duke destabilizuar hapësirën e njohur ndryshe si shtëpiake. Referencat skulpturore për Carl Andre tregojnë në mënyrë kritike metodat kompozicionale me origjinë minimaliste.

Në katin e sipërm të vilës gjenden punime që pasqyrojnë drejtpërdrejt kërkimet e përbashkëta të artistëve mbi historinë dhe kulturën shqiptare: dy vepra nga Anastasio që rrethojnë La Veggente, veprën e Tuttofuoco-s.

Instalacioni **La Veggente** (Androniqi Zengo) identifikon dhe gjurmon një moment themelor në historinë e afërt të Shqipërisë dhe të kaluarës së saj të rëndësishme kulturore: është një portret i Androniqi Zengo (1913 - 2000) një nga ikonat e artistëve shqiptarë, gati një orakull, e aftë të parashikonte kohët, duke u kthyer në një figurë me rëndësi të madhe për brezat e ardhshëm. Fuqia e Androniqit përqendrohet në syrin e tretë, pika e kanalizimit e përfaqësuar nga një lule ekzotike dhe e fuqishme, orkidea, sa e brishtë në të njëjtën kohë dhe e fuqishme, një bimë që jeton përmes bimëve të tjera dhe me bimë të tjera, një lule e importuar në Evropë si provë e prekshme e lavdisë imperialiste.

Celibe-2021, gjithashtu nga Anastasio: një grup polifonik i Gjirokastrës këndon këngë tradicionale shqiptare, këngë për dasma apo funerale, këngë lamtumire dhe nostalgjie. Grupi polifonik këndon, por tingulli është i mbytur, pothuajse i padëgjueshëm: ai transmetohet drejtpërdrejt në anën tjetër të Adriatikut, në molin e portit të Barit dhe në Grecia Salentina, afër Lecce-s. Kënga, në fakt, do të transmetohet si pjesë e instalacionit inaugurues të CORA, qendra për artin bashkëkohor në Castrignano dei Greci.

Attraverso-2021, nga Anastasio, është një perde e brishtë dhe tejdukshme që derdhet nga basorelievi i krijuar për fasadën e ndërtesës së Kryeministrisë në Tiranë, një vepër e periudhës komuniste. Rrëfimi i basorelievit, me karakter të fortë propagandistik dhe retorik, këtu zërthehet dhe transferohet në një perde dantelle. Mbivendosja sjell errësirën origjinale monumentale në dialog të drejtpërdrejtë me estetikën shtëpiake të perdes / diafragmës së ndërfutur midis së jashtmes dhe së brendshmes. Historia, ngjarjet e saj dhe ndikimi i tyre në fatet individuale shihen nga një dimension i brendshëm dhe zbulohet, gjysmë transparent. Si një kujtim i paprekshëm, por i tanishëm, perdia ngjyros brendësinë e formave të së kaluarës, duke lehtësuar ndikimin e tyre, ndërsa ende i kujton ato.

Si një projekt ndërkulturor, ekspozita I VEGGENTI qëndron si një moment historik në marrëdhëniet midis dy vendeve kaq të afërta, e po kaq të largëta.

INFORMACIONE UDHËZUESE

Rr. Ibrahim Rugova , Vila e vjetër përballë One Telecommunications

Orari: 10 - 13 | 17 - 20

Tel.: +355 67 664 5757

email: info@harabel.com.al

KONTAKTI PËR SHITYP

HARABEL
Contemporary Art Platform



gatti1928





Ambasciata d'Italia
Tirana

HARABEL CONTEMPORARY ART PLATFORM- Sky Tower Tirana, Rruga Ibrahim Rugova,
Tirana 1000, Albania|

Tel.: +355 67 664 5757/

email: info@harabel.com.al

www.harabel.com.al /

ANDREA ANASTASIO

Lindur në Romë në 1961, ai studioi filozofi dhe histori arti, duke u diplomuar në Universitetin e Ca' Foscari në Venecia. Që nga mesi i viteve '80 ai ka ndjekur një rrugë artistike të ndikuar nga mjeshtra të tillë si Ettore Sottsass dhe Bruno Munari dhe nga muzika serike, mendimi fetar oriental dhe misticizmi islamik. Ai ka krijuar projekte për Artemide, Memphis, Galerinë e Dizajnit të Milanos, Sawaya & Moroni dhe Danese, duke e vendosur veten si protagonist të dizajnit të ri Italian.

Në të njëjtën kohë ai riinterpretoi dhe çmimizoi kulturën e dizajnit industrial përmes artit, duke nisur një reflektim mbi hapësirat shtëpiake dhe filozofinë e të jetuarit. Në 1992 ai u transferua në Indi, ku kontribuoi në katalogimin e arkitekturës islamike indiane për UNESCO dhe mori pjesë në projekte për rinovimin e teknikave tradicionale artizanale.

Në vitet e fundit ai ka bashkëpunuar me studion e dizajnit Mehotra të Mumbai, me Institutin Studimor Urbanistik të Mumbai dhe me botuesin Tara Books të Chennai, me të cilin ka botuar "Fingerprints" në 2009 dhe "Alone in the Forest" në 2013. Që nga viti 2005 ai ekspozoi në: Galeria Alessandra Bonomo - Romë / Galeria Corraini - Mantova / Galeria Luisa Delle Piane - Milano / Galeria Giustini Stagetti - Romë / GallerySke - Bangalore, New Delhi.

Kërkimi i tij përqendrohet në manipulimin e objekteve, mallrave të konsumit dhe subjekteve të kontekstit shtëpiak për të gjeneruar qarqe të shkurtra gjuhësore dhe sabotim të kuptimit. Ai është i interesuar në studimin e poetikës dhe konvergencën e mundshme midis artit dhe dizajnit. Ai ka marrë pjesë në rezidencën në Muzeun Isabella Stewart Gardner në Boston në 2005 dhe 2008, dhe ka ekspozuar në ekspozita vetjake dhe në grupe në muze të ndryshëm italianë dhe ndërkombëtarë, përfshirë: Grand Palais-Paris, France; Darat Al Funun - Aman - Jordan; Muzeu i Artit dhe Arkitekturës Moderne DMA Dallas-SHBA; Muzeu ISGM Isabella Stewart Gardner Boston - SHBA; Kogei - Muzeu Prefekturor i Artit dhe Dizajnit - Toyama - Japoni; Musee des Arts Decoratifs - Montreal, Kanada; Muzeu Kombëtar Arkeologjik i Napolit MANN; MART i Trentos dhe Rovereto; Muzeu i Arteve të Shekullit 20 MAXXI - Romë; Muzeu Ndërkombëtar i Qeramikës MIC - Faenza; Palazzo Reale - Milano; MPP Muzeu Poldi Pezzoli - Milano; Trienalja e Milanos; WEX Wexner Center for the Arts - Ohio - SHBA; Muzeu YUZ - Shangai, Kinë.

Ai fitoi çmimin "Best Light" në Salone del Mobile në Milano në 2017 dhe "Best Light" të vitit - SHBA 2017.

Është emëruar Ambasador i Dizajnit italian nga MIBACT në 2018 dhe 2019.

PATRICK TUTTOFUOCO

Lindur në Milano, 1974. Jeton dhe punon në Milano.

Praktika e Patrick Tuttofuoco thur një dialog midis individëve dhe aftësisë së tyre për të transformuar mjedisin në të cilin jetojnë. Tuttofuoco ndërthur Modernizmin dhe Pop-in dhe e shtyn figuracionin drejt abstraktes, duke përdorur njeriun si një paradigmë të ekzistencës, matricës dhe njësisë matëse të realitetit. Nga ky proces interpretues dhe njohës, prodhohen versione të pafundme të individit dhe kontekstit në të cilin ai jeton, nga të cilat gjenerohen forma të afta për të gjallëruar skulpturat.

Patrick Tuttofuoco ka marrë pjesë në Bienalen e 50-të të Venecias (2003), Manifesta 5 (2004), Bienalen e 6-të të Shangait (2006) dhe Bienalen e 10-të të Havanës (2009). Punimet e tij janë



Ambasciata d'Italia
Tirana

eksponuar në institucione të ndryshme ndërkombëtare si Fondacioni Sandretto Re Rebaudengo, Torino, Itali (2006) dhe Künstlerhaus Bethanien, Berlin (2008).

Ndër shfaqjet më të fundit solo dhe në grup: It's always been about time, BASE, Firenze (2021); L'amor che move is sole e l'altre stelle (Dashuria që lëviz diellin dhe yjet e tjerë), CityLife, Milano (2021); REAL ITALY, MAXXI, Romë (2020); 10x100 Fabrika e artit bashkëkohor, Giovanardi Spa, Concorezzo, Monza, Itali (2019); Elevatio Corpus, Tre Projekte për Ghizzano, Ghizzano, Pisa, Itali (2019); Gremio Ermanno Casoli, Serra San Quirico, Ankorë, Itali (2019); Galleria Federica Schiavo Milano, Itali (2019); WP Store, Firenze - Bolonjë - Milano, Itali (2019); Triennale, Milano, Itali (2018); Casa Italia, Pyeongchan, Korea e Jugut (2018); Maxxi, Romë, Itali (2018); Galleria Cracco, Milano, Itali (2018); MACRO, Romë, Itali (2017); OGR, Grandi Officine Riparazioni, Torino, Itali (2017); Plasma Plastic Modern Art, Milano, Itali (2017); Mega, Venecia, Itali (2017); Galleria Federica Schiavo, Milano, Itali (2016); HangarBicocca, Milano, Itali (2015); Projekti dispari & dispari, Reggio Emilia, Itali (2015); Piazzetta Brera, Milano, Itali (2015); Caserma Ettore De Sonnaz, Torino, Itali (2015); PAC, Milano, Itali (2015); Studio Guenzani, Milano, Itali (2014); Muzeu Carlo Zauli, Faenza, Itali (2014); Bienalja e 2-të Ndërkombëtare e Artit Xinjiang, Xinjiang, Kinë (2014); Muzeu Antinori Familiae, San Casciano, Firenze, Itali (2013); Instituti Kulturor Italian i Madridit, Madrid, Spanjë (2013); MAMbo, Galleria e Artit Modern të Bolonjës, Bolonjë, Itali (2013); Palazzo Borghese, Romë, Itali (2012); GAM, Milano, Itali (2012); Galleria Marianne Boesky, New York, USA (2012); Art Metropole, Toronto, Kanada (2012); Kunstverein Arnsberg, Arnsberg, Gjermani (2012); Qendra për Art Bashkëkohor FUTURA, Pragë, Republika Çeke (2012); Projekti Peres, Berlin, Gjermani (2011); Galleria Anti e Artit Bashkëkohor, Mestre, Venecia, Itali (2011); MARTa, Herford, Gjermani (2011); MACRO, Romë, Itali (2010); Dersa Comfort, Cyrih, Zvicër (2010); Fondacioni Pomodoro, Milano, Itali (2010); Le Magasin, Grenoble, Francë (2010); GAMeC, Bergamo, Itali (2010); MART, Rovereto, Itali (2010); Ambasada Italiane në Berlin, Berlin, Gjermani (2010); Triennale di Milano, Milano, Itali (2010); Fondacioni Sandretto Re Rebaudengo, Torino, Itali (2010); Le Dictateur, Milano, Itali (2010); Galleria Pilar Corrias, Londër, MB (2009); Peep-Hole, Milano, Itali (2009); Supportico Lopez, Berlin, Gjermani (2009); Galleria e Arteve e Hamilton, Hamilton, SHBA (2009); Muzeu i Artit Bashkëkohor të Shekullit 21, Kanzawa, Japoni (2009).

HARABEL

Harabel është një organizatë jofitimprurëse, me qendër në Tiranë që përqendrohet në promovimin e artit bashkëkohor. Lindur nga nevoja për ta bërë artin bashkëkohor një pasuri të përbashkët, të lirë dhe të ndjekur nga shumëkush, Harabel synon të jetë një ndërmjetësues nxitës për ndërhyrje urbane dhe reflektive, duke ofruar një hapësirë ndërdisiplinore për eksperimentim dhe kërkim, dhe ka një bashkëpunim të qëndrueshëm me artistë bashkëkohorë, si edhe me hulumtues, kuratorë, arkitektë, sociologë, publicistë, shkencëtarë dhe specialistë të fushave të tjera, me qëllim ndikimin në qytet, në drejtime të ndryshme sociale dhe edukative. Harabel është krijuar në 2018-ën nga Ajola Xoxa, në rolin e promovueses së kulturës dhe Driant Zenelit, artist pamor.
www.harabel.com.al



Ambasciata d'Italia
Tirana

Arthub është një platformë jofitimprurëse e bazuar në Shanghai dhe Hong Kong, kushtuar krijimit dhe përhapjes së artit bashkëkohor. Arthub (i lindur në 2007 si Arthub Asia), lindi nga dëshira për të eksploruar dhe eksperimentuar me mundësitë e platformave bashkëpunuese. Ajo filloi në një kohë urgjence, kur praktikat artistike bashkëkohore kineze kishin një histori të shkurtër të zhvillimit strukturor dhe u përballën me kontradikta dhe probleme të "përkthimit", veçanërisht në lidhje me metodologjitë e kërkimit brenda kontekstit kinez dhe aziatik në përgjithësi. Duke vepruar si një ndërmjetës ndërkulturor, Arthub organizon bashkëpunime midis artistëve dhe institucioneve aziatike dhe të huaja përmes prodhimit të veprave artistike, ekspozitave, botimeve dhe aktiviteteve arsimore. Me këtë aftësi, Arthub Asia është një përfaqësi, një eksperiment që synon të lidhë njerëz krijues lokalë dhe globalë të ngjashëm, duke grumbulluar në të njëjtën kohë njëfarë shkalle autoriteti në spektrin e artit pamor aziatik. www.arthubasia.org

CAPO D'ARTE

Capo d'Arte është një organizatë jofitimprurëse italiane kushtuar artit bashkëkohor. Ajo u themelua në vitin 2009 nga Francesca Bonomo dhe Francesco Petrucci, me idenë për të sjellë format më të përparuara të artit në Gagliano del Capo: një fshat i vogël në majë të Pulias, një zonë e cila rrallë e kishte provuar më parë diçka të tillë. Që nga fillimet e tij, Capo d'Arte ka organizuar ekspozita verore që shfaqnin punën e artistëve të njohur ndërkombëtarë, në kontekstin e një toke me pamje nga Mesdheu, e cila gjithmonë ka funksionuar si një udhëkryq midis Evropës, Ballkanit, Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut. Për më tepër, që nga viti 2016 shoqata është partner i Akademisë Franceze në Romë. Çdo vit, ata organizojnë së bashku në Gagliano del Capo projekte dhe ekspozita me artistë rezidentë në Villa Medici.

www.capodarte.it



Ambasciata d'Italia
Tirana



Ambasciata d'Italia
Tirana

Patrick Tuttofuoco
Andrea Anastasio

curated by
Daide Quadrio
Ajola Xoxa

I VEGGENTI

July 21st - September 15th 2021

St. Ibrahim Rugova, old villa in front of ONE store, Tirana

HARABEL
Contemporary Art Platform



gatti
1928



HARABEL
Contemporary Art Platform



gatti1928

